VENDIM
Nr. 686, datë 23.10.2019

PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT

(ndryshuar me VKM nr. 745, datë 20.11.2019)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, i cili është *2 300 (dy mijë e treqind) praktikantë* për të gjitha institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për një vit shkollor.

2. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, i paguan praktikantit, çdo muaj, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

3. Shpërndarja e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për të gjitha institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për secilin vit shkollor, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, bazuar në kërkesat e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

4. Efektet financiare për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019 mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në buxhetin e vitit 2019, sipas numrit të praktikantëve të pranuar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama